



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
UNIVERSITETI I ARTEVE  
REKTORATI  
REKTORI

Nr. 1039 prot.

Tiranë, më 28.08.2024

URDHËR

Nr. 1, datë 28/08/2024

PËR


**EMËRIMIN E DEKANIT TË FAKULTETIT TË ARTIT SKENIK  
TË UNIVERSITETIT TË ARTEVE**

Në mbështetje të nenit 42 pika 5 të ligjit nr. 80/2015 "Për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në Institucionet e Arsimit të Lartë në Republikën e Shqipërisë", të nenit 39 pika 4 të Rregullores "Për organizimin e zgjedhjeve për autoritetet drejtuese dhe Senatin Akademik në Universitetin e Arteve", të kreut V të ligjit nr. 7961, datë 12.07.1995 "Kodi i Punës së Republikës së Shqipërisë", i ndryshuar si dhe të Vendimit të Komisionit Zgjedhor të Fakultetit të Artit Skenik nr. 5, datë 21.06.2024 "Për shpalljen e rezultatit përfundimtar për drejtues të njësisë kryesore dhe drejtues të njësisë bazë në Fakultetin e Artit Skenik, në Universitetin e Arteve",

URDHËROJ:

1. **Prof. Miltiadh KUTALI** emërohet **Dekan i Fakultetit të Artit Skenik**, të Universitetit të Arteve.
2. Efektet financiare të fillojnë nga data **01.09.2024**.
3. Përcjelljen, brenda 7 (shtatë ditëve) të urdhrave të emërimit të drejtuesve të njësive bazë dhe zëvendësdekanit nga Dekani.
4. Ngarkohen për zbatimin e këtij urdhri Drejtoria e Menaxhimit të Burimeve Njerëzore & IS/P-A dhe Drejtoria Ekonomike në Universitetin e Arteve.
5. Ky urdhër të shpallet në faqen zyrtare të Universitetit të Arteve.

**Ky urdhër hyn në fuqi menjëherë.**

REKTORI  
  
Prof. Dr. Erald BAKALI